

URDHËR
Nr. 308, datë 12.10.2022

**PËR USHTRIMIN E DETYRAVE SI PËRGJEGJËSE PËR SISTEMIN *E-LEJE* NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të urdhrit të Kryeministrit nr. 26, datë 3.2.2020, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, si dhe të shkresës zyrtare me nr. 2114 prot., datë 6.10.2022, me lëndë “Kërkesë”,

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e znj. Pranvera Alijaja për ushtrimin e detyrave si përgjegjëse për sistemin *E-Leje*, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), krahas ushtrimit të detyrës aktuale të Specialistit në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

2. Znj. Alijaja do të ushtrojë detyrat shtesë si përgjegjëse për sistemin *E-Leje*, duke filluar nga data 13.10.2022, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi